



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!


SI TË BËHESH MUSLIMAN

Botuar nga: SHB Logos-A

Të gjitha të drejtat e këtij libri i takojnë botuesit

BESIMI I DREJTË DHE VEPRIMI I VLEFSHËM	5
BESIMI ISLAM.....	5
PARIMET E BESIMIT ISLAM	7
BESIMI NË NJË TË VETMIN ALL-LLAH xh.sh.	7
BESIMI NË ENGJËJT	8
BESIMI NË TË DËRGUARIT.....	9
BESIMI NË LIBRAT E ZOTIT.....	10
BESIMI NË DITËN E GJYKIMIT	10
BESIMI NË DETERMINIMIN (KADERIN) E ZOTIT.....	11
LIGJI ISLAM - SHERIATI.....	12
DËSHMIA (SHEHADETI).....	13
TË FALURIT (SALATI - NAMAZI)	13
PASTRIMI I PASURISË (ZEKATI).....	14
AGJËRIMI	15
PELEGRINAZHI (HAXHI)	16

Me qëllim që muslimanëve t'ua prezentojë mësimet burimore islame, “Xhem’ij-jetud-davetil-islamij-je-ti” në Libi në krye me dijetarin e famshëm, Muhammed Subhi-un, filloi me botimin e veprave për çështjet themelore të Islamit. Një nga ato është edhe kjo broshurë e shkurtë e Besimit islam dhe shpresojmë se publikimi i saj edhe në gjuhën tonë do t’i ndihmojë lexuesit shqipfolës për të qenë gjithmonë në burimin e Besimit islam.



Njeriu gjatë jetës synon realizimin e dy qëllimeve kryesore:

E para - të ndërtojë personalitetin dhe të arrijë qetësinë shpirtërore.

E dyta - të ketë qëndrim të drejtë ndaj njerëzve të tjerë, të ushqejë mirëkuptimin, solidaritetin, bashkëjetesën me ata që jeton, meqë misionin e vet jetësor njeriu mund ta kryejë vetëm në bashkësi.

Islami është fe me anë të së cilës njeriu në mënyrë më të plotë i realizon dy qëllimet në fjalë, fe që njeriun e shpie dhe udhëzon në rrugën e së vërtetës, e ndihmon për ta dëshmuar arsyeshmërinë e ekzistimit të tij, realizimin e detyrave që i ka në këtë botë dhe arritjen e fatit në botën e amshueshme (Ahiret). Parakushtet për arritjen e këtyre dy qëllimeve janë:

BESIMI I DREJTË DHE VEPRIMI I VLEFSHËM

Për të qenë njeriu musliman i vërtetë, është e domosdoshme që me zemër e me forcën e arsyes ta përqafojë mësimin islam, sipas tij ta organizojë jetën e vet dhe t'i ndërtojë marrëdhëniet me të tjerët, sepse nuk mjafton vetëm të dijsih e të mos veprosh sipas po asaj dijenie. Muslimani medoemos duhet t'i harmonizojë fjalët e veprat, sepse Islami është teori e praktikë, mendim e aksion, devotshmëri e aktivitet. Ai është tërësi e plotë e harmonike që nuk duron t'i shtohet ose t'i hiqet gjë. All-llahu xhel-le shanuhu shpreh neveri ndaj fjalëve pa vepra: “O ju që besuat, pse e thoni atë që nuk e punoni? Tek Allahu është shumë e urrejtur ta thoni atë që nuk e punoni!” (Es-Saff:2,3).

BESIMI ISLAM

Islami në vend të parë e ka vënë besimin, duke ia kushtuar kujdesin më të madh pastërtisë së tij. Ai e dënon shtrembërimin e besimit, e më i ashpër është ndaj politeizmit. Muhammedi alejhisselam tërë periudhën trembëdhjetëvjeçare të punës së tij si I Dërguar ia ka kushtuar luftës kundër politeizmit, dhe kjo ka qenë periudha më e rëndë e veprimtarisë së tij si I Dërguar. Të gjithë ata që atëherë e pranuan Islamin, kaluan nëpër krajata e sprova të mëdha jetësore: luftëra me politeistët, persekutime e ndjekje, komplete e vrasje.

Islami nisët nga bazamenti në të cilin qëndron, e ky është besimi. Ai, në mënyrë eksplicite thotë se muslimani nuk guxon të adhurojë gjë tjetër përveç Një të Vetmit All-llah, që është i pakufishëm me fuqinë, diturinë dhe ekzistencën e Vet. Askush, përveç All-llahut, nuk duhet të lutet dhe prej askujt, përveç All-llahut, nuk duhet kërkuar ndihmë e falje.

Dikush mbase do të shtrojë pyetjen: pse t'i besohet Një të Vetmit All-llah? Përgjigjja më e thjeshtëzuar është: besimi në Një të Vetmit All-llah i përgjigjet rendit natyror të çështjeve, ai është në pajtim me natyrën e njeriut dhe arsyeja e tij pranon: *“Ky është rend i All-llahut dhe sipas këtij rendi All-llahu e ka krijuar njeriun. Në krijimtarinë e All-llahut nuk ka ndryshime. Vetëm ky është besimi i drejtë.”*

Historia njerëzore ka vërtetuar se periudhat në të cilat njeriu ka adhuruar skulpturat, duke mohuar arsyen dhe përkatësinë e vet, janë periudha të dobësisë, të tatëpjetës dhe të paditurisë së tij.

Besimi në ekzistimin e Një të Vetmit All-llah, Të Gjithëfuqishëm dhe Të Gjithëdijshëm, bën që njeriu t'i qëndrojë besnik të vërtetës, e nxit atë të bëhet fisnik e të flijohet dhe ngjall te ai ndjenjat e qetësisë, ngaqë All-llahu xhel-le shanuhu e frymëzon, e orienton dhe e udhëzon atë.

Besimi në All-llahun xhel-le shanuhu do të thotë çlirim i njeriut nga të gjitha llojet e besëtytnive, të cilat, po të mbizotërojnë te njeriu, do ta shpartallonin mendimin e tij, do ta paaftësonin mendjen e tij, do të bëhesh njeri i pavendosur dhe do ta cenonin dinjitetin e tij. Besimi në Një të Vetmit Zot është në pajtim me kërkesat e mendjes së njeriut, ai e ndihmon dhe i hap horizonte të reja, zbulon aftësitë e fshehta të tij dhe rrugët e dëshmitit të tij në jetë, ai e çliron prej çfarëdo frike. Besimtari i frikohet vetëm Zotit dhe askujt tjetër, sado i fortë dhe i tmerrshëm të jetë ai. Ai është në lidhje të drejtpërdrejtë me Burimin e fuqisë. Besimi e ruan të mos i nënshtrohet askujt

tjetër përveç All-llahut, sepse përkulja ndaj të tjerëve, përveç All-llahut, është poshtërim për njeriun. Besimi kalit vullnetin e tij, ia forcon vendosmërinë, e mëson t'u përballojë të gjitha vështirësitë, e bën të paepur e të paluhatshëm.

Njerëzimi nuk mund të synojë ndonjë ideal më të lartë përpos tij (besimit), me të cilin arrihet e vërteta e shembet e pavërteta.

PARIMET E BESIMIT ISLAM

Besimi islam ka gjashtë parime themelore: besimi në Një të Vetmin All-llah, besimi në engjëjt e Tij, besimi në Të dërguarit e Tij, besimi në librat e Tij, besimi në Ditën e Gjykimit dhe besimi në determinimin - përcaktimin e Tij (besimi në kaderin e Tij – A.A).

BESIMI NË NJË TË VETMIN ALL-LLAH XH.SH.

Të besosh në Një të Vetmin All-llah do të thotë: të pranosh se Ai, sipas qenies së Vet dhe attributeve që ka, është absolutisht i lirë, se vetëm Ai është i denjë për t'u adhuruar, se me asgjë nuk ngjason e as me Të diçka ngjason: “Me Të asgjë nuk ngjason. Ai dëgjon e di gjithçka”, se

është Krijues, Zotërues dhe Balancues i Gjithësisë dhe bëhet ajo që e do Ai: “Sikur në to (qiej e tokë) të kishte më shumë zotëra, do të shkatërroheshin edhe qiejt edhe toka”.

Kaptina e Kur’anit, “Ihlas,” përmban përcaktimet themelore të këtij parimi islam: “Thuaj: ‘Ai, All-llahu, është Një. All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë”

BESIMI NË ENGJËJT

Është e njohur se njeriu është krijesë e All-llahut. Mundësitë dhe njohuritë e tij kanë cakun e tyre përtej të cilit nuk mund të shkojnë, gjë të cilën e vërteton edhe shkenca; kriteret e tij nuk mund të jenë të sakta në shumë raste, e as që mund të përfshijnë dhe të depërtojnë në gjithçka që na rrethon. Ekzistojnë pra, botë të panjohura për njeriun në të cilat nuk mund të depërtojë plotësisht. Edhe në botën tjetër ekzistojnë disa çështje që njeriu nuk mund t’i kuptojë në bazë të arsyes, që aspak nuk e mohon ekzistimin e tyre, prandaj është jomirënjohëse që njeriu të mos pranojë atë që nuk mund ta shijojë dhe përjetojë me shqisat e veta.

Besimin në qeniet e padukshme shpirtërore - engjëjt - Islami e konsideron të pandashëm nga besimi i përgjithshëm. Engjëjt janë krijesa shpirtërore që punojnë ashtu siç u urdhëron All-llahu xh.sh. Disa nga ata janë të caktuar që Të dërguarve të All-llahut t’ua dorëzojnë Shpalljen, ndërsa të tjerët janë të ngarkuar me obligime të tjera: *“I frikësoben All-llahut që është mbi të gjitha dhe veprojnë ashtu siç u urdhërohet”*.

Nuk mund të jeshë musliman në qoftë se nuk u beson edhe engjëjve, sepse e vërteta përfshin botën materiale dhe jomateriale - shpirtin dhe materien, botën reale dhe botën sekrete.

BESIMI NË TË DËRGUARIT

Parimi i tretë, prej gjashtë parimeve themelore të Besimit islam, është besimi në të gjithë Të dërguarit e Zotit - njerëz që All-llahu xh.sh. i ka zgjedhur dhe ua ka dërguar Islamin, me detyrë që t'ua bartin popujve të tyre dhe kësisoj t'i nxjerrin nga errësira. Kjo ka qenë detyrë e të gjithë Të dërguarve të Zotit - prej Ademit a.s. e deri te Muhammedi a.s. Prandaj, Islami është i vetmi revelacion i Zotit për të gjithë njerëzit e botës: “Ju porositi nga feja atë që e porositi Nuhin dhe atë që të reveluam ty Ibrahim,Musa e Isa, prandaj përhapeni këtë fe dhe mos u përçani”. Feja e All-llahut, pra, në thelb është një dhe atë e predikuan të gjithë Të dërguarit e Zotit. Ky ka qenë qëllimi kryesor i misionit të tyre. Ajo vinte sipas nevojave të arsyes njerëzore dhe kërkesave të kohës e të mjedisit të popujve të veçantë. E, sa i përket thelbit të saj, ajo ka mbetur e pandryshueshme në të gjitha librat e zbritur nga Zoti. Prandaj, as që mund të jeshë musliman në qoftë se shkatërrohet ky unitet thelbësor, në qoftë se tentohet të ndërpritet kontinuiteti dhe të shkatërrohet thelbi i Shpalljes (p.sh. t'u besosh disa Të dërguarve të Zotit, e disave të mos u besosh), sepse Kur'ani ka këtë parim:”Ne nuk bëjmë dallim ndërmjet Të dërguarve të Zotit”.

BESIMI NË LIBRAT E ZOTIT

Besimi në Të dërguarit e Zotit nënkupton besimin në librat që ua ka reveluar All-llahu xh.sh. Prandaj, besimi në All-llahun xh.sh., engjëjt e Tij dhe në Të dërguarit e Tij është një tërësi e pandashme.

BESIMI NË DITËN E GJYKIMIT

Prej gjashtë parimeve themelore të Besimit islam, i pesti është besimi në botën e amshueshme, përkatësisht besimi në jetën pas vdekjes, kur njerëzit do të japin llogari për veprat që kanë bërë për së gjalli dhe kur do të shpërblehen, përkatësisht dënohen, sipas veprave që kanë bërë.

Besimi në jetën tjetër të përjetshme supozon përgjegjësinë e njeriut, e cila, në anën tjetër, supozon lirinë e tij, pa të cilën nuk do të ishte përgjegjës. Sepse, sikur të mos ishte dita kur çdo njeri do të japë llogari për veprat e bëra, përgjegjësia e tij nuk do të kishte kurrfarë vlere, do të ishte absurde, urtësia që i paraprin zgjedhjes së lirë të njeriut do të ishte e pavlefshme. Kësisoj edhe vetë jeta do të ishte e pavlefshme, sepse do të përfundonte pa kuptim e pa qëllim.

Besimi në jetën e amshueshme e lidhë njeriun me të vërtetën, e nxitë të jetë i drejtë e të bëjë vepra të mira. Ai e di se gjatë përpjekjeve për ta arritur këtë, do të hasë në vështirësi, por në të njëjtën kohë është i sigurt se feja do ta ndihmojë t'i kapërcejë ato. Atë e ushqen bindja se All-llahu xh.sh.

do ta shpërblejë edhe për përpjekjet që t'i realizojë këto vlera. Ai mund t'i realizojë ose të bie dëshmor në luftën për realizimin e tyre.

BESIMI NË DETERMINIMIN (KADERIN) E ZOTIT

Nuk mund të bëhesh musliman pa i besuar, në kuadër të kësaj që u parashtrua deri më tani, edhe determinimit (përcaktimit) të Zotit. E, të besosh në determinimin e Zotit, do të thotë të pranosh se All-llahu xh.sh. cakton dhe drejton çdo gjë. Ky besim nuk është në kundërshtim me zgjedhjen e lirë të njeriut, sepse nuk e mohon ekzistimin e shkakut të ndodhisë. All-llahu e ka krijuar shkakun, por edhe mundësinë e zgjedhjes që ai e ka në vete.

Besimi në determinimin - përcaktimin e Zotit përforcon mbështetjen e njeriut në Krijuesin dhe Balancuesin e gjithë asaj që ekziston. All-llahu xh.sh. kërkon nga njeriu të përdorë të gjitha mjetet që i ka në dispozicion dhe aftësitë mendore e fizike për realizimin e një qëllimi të caktuar, kurse rezultatën përfundimtar t'ia lërë Atij. All-llahu premtan se atëherë ndihma e Tij nuk do të mungojë: *“E, kur të vendosësh përfundimisht (të bësh diçka), mbështetu në All-llahun!”*

Besimi në determinimin - përcaktimin e Zotit, sipas të cilit ndodh gjithçka, i sjell qetësi njeriut në të gjitha vendimet që i merr dhe punët që i kryen.

LIGJI ISLAM - SHERIATI

Veprimi sipas Ligjit islam - Sheriatit, është pjesë përbërëse e Besimit islam. Ai, në të vërtetë, është pjesa praktike e tij, shprehja e njëmendtë e besimit në All-llahun xh.sh., në engjëjt e Tij, Të dërguarit, librat, Ditën e Gjykimit dhe determinimin e Zotit.

Ligji islam e përcakton qëndrimin e muslimanit ndaj All-llahut xh.sh., qëndrimin ndaj njeriut tjetër, familjes, shoqërisë dhe njerëzimit në përgjithësi. Të gjitha këto marrëdhënie janë të gërshtuara dhe të lidhura në mënyrë të ndërsjellë. Ato kanë për qëllim ta zhvillojnë personalitetin integral, t'i rregullojnë marrëdhëniet në familje e shoqëri, shkurt - jetën e njeriut ta bëjnë më të lumtur.

Lutja (ibadeti), në të gjitha format e veta, është lidhje ndërmjet njeriut dhe All-llahut xh.sh., është verifikimi në praktikë i besimit të njeriut. Me lutje përcaktohet vetë qëndrimi i njeriut ndaj njerëzve të tjerë dhe, si i tillë, ai gjithnjë është pozitiv, sepse njeriu është i vetëdijshëm se All-llahu xh.sh. qëndron gjithmonë mbi të dhe mbi veprat e hapta e të fshehta të tij. Kjo ndjenjë e pranisë së përhershme të Zotit pastron ndërgjegjen dhe zemrën e tij, kështu që edhe qëllimet gjithnjë i ka fisnike. Prandaj, të gjitha format e lutjes (ibadetit) kanë për qëllim ta thellojnë qëndrimin e njeriut ndaj All-llahut xh.sh., të ndikojnë që marrëdhëniet e tij me të gjithë njerëzit të jenë në nivelin më të lartë.

Lutja në Islam manifestohet nëpërmjet pesë kushteve islame: deklarimit të maksimës islame - Kelimeit shehadetit (fjalës së dëshmimit): *LA ILAHE IL-LALL-LLAH MUHAMMEDUN RESULULL-LLAH*, nuk ka zot tjetër përveç All-llahut, Muhammedi është I Dërguari i All-

llahut; të falurit (salatit - namazit), agjërimit, pastrimit të pasurisë (zekatit) dhe pelegrinazhit (haxhillëkut).

DËSHMIA (SHEHADETI)

Të deklaroj se s'ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi a.s. është I Dërguari i All-llahut - është parimi i parë dhe themelor i Islamit. Në të bazohet çdo gjë. Formalisht, ai ka dimension të brendshëm e të jashtëm: me zemër të pranosh se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është I Dërguari i Tij, e pastaj me fjalë ta deklaroj dhe me vepra ta vërtetosh këtë. Në thelb, gjithë kjo është një tërësi e pandashme. Ai që dëshiron të jetë musliman, medoemos duhet ta pranojë këtë parim themelor islam, të tillë siç është. Nuk mund të jetë musliman, për shembull, ai që pranon dhe deklaron vetëm për pjesën e parë të kësaj maksime islame, ndërsa mohon pjesën tjetër të saj.

TË FALURIT (SALATI - NAMAZI)

Të falurit është qëndrimi më i drejtpërdrejtë i muslimanit ndaj All-llahut xh.sh. Ta kryesh pesë herë në ditë, do të thotë t'i drejtohesh vazhdimisht All-llahut. Me të njeriu pastron shpirtin dhe trupin e vet. Abdesti nuk është larje vetëm e pjesëve të jashtme të trupit të njeriut, por edhe

simbol i pastrimit të brendshëm të tij, si përgatitje për t'iu drejtuar drejtpërdrejt All-llahut xh.sh. Sepse, zemra e shpirti që i drejtohen Zotit, medoemos duhet të jenë të pastra nga urrejtja dhe nga të drejtuarit kujtdo qoftë tjetër përveç All-llahut.

Përveç këtyre, të falurit ka edhe të mira të tjera që janë të një rëndësie të madhe shoqërore. Të falurit që njeriu e kryen bashkërisht (me xhemaat), është më i mirë dhe më i vlefshëm për njëzet e pesë shkallë nga të falurit që e kryen individualisht, sepse të falurit që kryhet bashkërisht (me xhemaat) simbolizon unitetin, bashkëpunimin dhe solidaritetin midis njerëzve, pa marrë parasysh prejardhjen sociale dhe pozitën shoqërore të tyre. Para All-llahut xh.sh. të gjithë janë të barabartë. Të falurit (namazi me xhemaat) i bashkon zemrat dhe ndjenjat e tyre dhe u ndihmon në realizimin e qëllimit të përbashkët të tyre. Ky unitet veçanërisht vjen në shprehje me rastin e faljes së namazit të xhumasë (të premtëve) dhe me rastin e faljes së namazeve të të dy festave, festës së Agjërimit (Ramazanit) dhe festës së Viktimës (Kurbanit).

PASTRIMI I PASURISË (ZEKATI)

Pastrimi i pasurisë (zekati), sipas Islamit, është pjesa e caktuar që ndahet nga pasuria që ka arritur kufirin e quajtur “nisab”. Të pastrosht pasurinë (të japësh zekat) është lutje - ibadet. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka, Kur’ani në shumë vende e përmend së bashku me të falurit (namazin), ngaqë obligimi ndaj shoqërisë njëherit është edhe obligim ndaj Zotit.

Zekati, nga ana tjetër, e pastron pasurinë dhe e ruan njeriun nga koprracia dhe egoizmi: *“Merr nga pasuria e tyre pjesën me të cilën do t’i pastrosb dhe moralisht do t’i ngritish”*. Zekati, si i tillë, garanton sigurinë shoqërore dhe është njëri nga faktorët më të rëndësishëm për thellimin e marrëdhënieve të njëmendta shoqërore, për përhapjen e dashurisë së ndërsjellë dhe solidarizimin midis njerëzve. Nga pasuria e të pasurit merret pjesa e caktuar *që është e drejtë e të varfërit* (nënvizimi ynë) dhe në këtë mënyrë vendoset harmonia në shoqëri.

AGJËRIMI

Muslimanit i është destinuar ta agjërojë muajin e Ramazanit në mënyrë që agjërimi, në qoftë se e kryen ashtu siç thotë Kur’ani, ta ngritë në nivelin e engjëllit. Ai ka për qëllim ta forcojë vullnetin dhe vendosmërinë e njeriut, ta mësojë të jetë i durueshëm me rastin e ballafaqimit me vështirësitë e jetës dhe ta ndihmojë të bëhet sundues i pasioneve të veta, ta mësojë të bashkëndjejë me vëllain që është në hall, ta ndihmojë t’i kapërcejë më lehtë vështirësitë e jetës.

Agjërimi, përveç kësaj, ngërthen në vete edhe vlera të tjera shpirtërore, që janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për humanizimin e njeriut dhe të shoqërisë në përgjithësi.

PELEGRINAZHI (HAXHI)

Nëse është i pasur, i shëndoshë dhe i siguruar, muslimani e ka për detyrë që një herë në jetë ta kryejë pelegrinazhin - ta vizitojë Kaben në Mekë: *“Kush ka mundësi, e ka për detyrë ta vizitojë Shtëpinë e All-llahut”*.

Dobia nga pelegrinazhi është e shumëfishtë. Ai është lutje, kurse shfaqet me anë të tavaf-it - sjelljes rreth Kabes, sa’j-it - vrapimit mes Safas (Safa: kodrinë në Mekë - A.A.) dhe Merve-s (Merve: kodrinë në Mekë - A.A.), vukuf-it - qëndrimit në Arefat dhe me ceremoni të tjera fetare që në muajin e pelegrinazhit kryhen në vendet e shenjta islame në Arabi.

Pelegrinazhi, në të vërtetë është *kongresi i muslimanëve të mbarë botës* (nënvizimi ynë), në të cilin tubohen për t’u njohur sa më mirë, që është bazë për harmoninë dhe dashurinë e tyre të ndërsjellë. Ai gjithashtu simbolizon barazinë e njerëzve para Krijuesit të tyre, All-llahut xh.sh., pa marrë parasysh dallimet që i karakterizojnë në këtë botë, sepse për Zotin është më i afërt dhe më i dashur ai që më shumë i përkulet.

Pelegrinazhi është kushti i pestë islam dhe së bashku me katër kushtet e përmendura e përbën godinën islame. Me plotësimin e të gjitha këtyre kushteve, muslimani e siguron lumturinë në këtë botë dhe shpëtimin në botën e ardhshme.

Krahas kësaj që u tha, besimi dhe veprimi i drejtë është i plotë kur në vete përfshinë edhe këtë që pason:

a) shmangia nga ndalesat

Musliman i vërtetë është vetëm ai që krejtësisht shmanget nga gjithçka që është ndaluar nga All-llahu, siç është alkooli, prostitucioni, ngrënia e mishit të derrit dhe e shtazëve të ngordhura, kamata, mashtrimi, gënjeshtria, vjedhja, dhuna, sulmi kundër pasurisë dhe nderit të njerëzve të tjerë e të ngjashme.

Kjo shmangie nuk do të thotë kufizim i lirisë, siç do të mund të konsideronte ndonjë i pa-informuar. Gjithçka që ndalohet, ndalohet për arsye se është e dëmshme për njeriun.

Çdo ndalesë ka arsyen dhe urtësinë e vet. All-llahu xhel-le shanuhu njeriut ia tërheq vërejtjen që të ruhet nga ajo që është e ndaluar, në mënyrë që ta mbrojë trupin, mendjen dhe shpirtin e vet, si dhe shoqërinë në përgjithësi, nga gjithçka që do t'i shkaktonte dëm. Përpos kësaj, shmangia nga ndalesat njeriut i sjell shpërblim të madh nga All-llahu xh.sh., sepse ai në këtë mënyrë tregon se i nënshtrohet Krijuesit.

b) zbatimi i urdhrave

Musliman i vërtetë është vetëm ai që vazhdimisht i nënshtrohet All-llahut xh.sh., duke zbatuar atë që urdhëron Ai, e duke iu shmangur asaj që e ka ndaluar. Dobia më e madhe për njeriun është kur, duke iu nënshtuar, pa marrë parasysh a është i njohur plotësisht ose jo me urtësinë e urdhrave dhe të ndalesave të Tij, e arrin kënaqësinë e All-llahut.

Edhe ajo që e ka ndaluar ose urdhëruar Muhammedi a.s., konsiderohet ndalesë dhe urdhër i All-llahut xh.sh., sepse ai nuk ka folur arbitrarisht, por vetëm atë që i ka ardhur përmes Shpalljes, siç thotë edhe vetë Kur'ani: *“Merrni atë që ju ka sjellë I Dërguari, kurse lëreni atë që ua ka ndaluar”*.

c) etika

Të gjitha urdhrat islame dhe ndalesat e Sheriatit, si dhe lutja me të gjitha format e veta, janë të lidhura ngusht me moralin (ahlak-un) islam dhe së bashku me të përbëjnë një tërësi organike.

Etika (moral) zë një vend shumë të rëndësishëm në Fenë Islame; ajo zë vendin e shpirtit në raport me trupin. Për rëndësinë që ka ajo më së miri dëshmojnë fjalët e Të Dërguarit të Zotit: *“Jam dërguar që ta përsos moralin”*.

Lutja dhe qëndrimi ndaj All-llahut xh.sh. dhe shoqërisë, nëse nuk e ndihmojnë ngritjen morale, nuk kanë kurrfarë vlerash tek Ai. Përkundrazi, All-llahu këtë e konsideron mëkat. Lutja është formalitet i thjeshtë në qoftë se nuk ka kuptim moral.

Të falurit (namazi), për shembull, duhet ta pengojë njeriun nga veprat e këqija e ta nxisë për vepra të mira: “E pranoj namazin e atij që përkulet para madhësisë Sime, që nuk i sulmon krijesat e Mía, që nuk është i padëgjueshëm, që Më ruan në kujtesë dhe që ka mëshirë për të varfërit, të pafuqishmit dhe të pafatët” (Hadis-i kuds).

Zekati pastron pasurinë dhe moralisht e ngrit njeriun: “Merr nga pasuria e tyre pjesën me të cilën do t’i pastrosh dhe moralisht do t’i ngritish”.

Muhammedi a.s. e ka zgjeruar kuptimin moral të zekatit, duke thënë: “Buzëqeshja e bukur është lëmoshë (sadaka), kërkesa për të bërë mirë ndërsa ndalesa për të bërë keq janë lëmoshë, lëmoshë është t’ia tregosh rrugën atij që e ka humbur, sadaka është kur nga rruga heq pengesën, të derdhësh ujë në kovën e tjetrit është lëmoshë, ta shikosh me ëmbëlsi atë që të shikon shtrembër është sadaka”.

Në qoftë se agjërimi nuk ka në vete kurrfarë kuptimi moral, atëherë ai është uri e thjeshtë: *“Kush përgojon të tjerët, nuk ka nevojë ta lërë ushqimin dhe pëjën”*.

Haxhi supozon gjithashtu edhe sjelljen e mirë dhe shmangien nga çdo e keqe: “Pelegrinazhi (haxhi) është në muajt e njohur. Kush e kryen haxhin gjatë atyre muajve, nuk guxon të bëjë asgjë të keqe...”.

Kur me një rast e kanë pyetur Të Dërguarin e Zotit se besimi i kujt është më i plotë, ai është përgjigjur: *“I atij që ka moral më të fortë”*. Atëherë, njëri nga të pranishmit tha se në fqinjësi ka një grua që gjatë natës falë nafile (të falurit – namazi që nuk është i obligueshëm - farz - A.A.), ndërsa gjatë ditës agjëron nafile dhe jep sadaka, por me gjuhën e vet i shqetëson fqinjtë. Atëherë, Muhammedi a.s. i tha: *“Te ajo s’ka kurrfarë të mire. Ajo do të shkojë në ferr”*. Dikush përmendi një grua që pak falet e agjëron nafile dhe jep pak sadaka, por nuk i shqetëson fqinjtë. *“Ajo do të shkojë në parajsë”* - tha Muhammedi a.s.

Nga kjo që u theksua më lart shihet vendi dhe rëndësia që Islami ia kushton moralit. Prandaj, nëse dëshiron të bëhesh musliman i vërtetë, është e nevojshme që të keshë edhe moral të fortë, sepse vetëm në këtë mënyrë do ta fitosh kënaqësinë e All-llahut.

Qëndrimi i drejtë i muslimanit nuk është obligim (farz) vetëm ndaj muslimanit tjetër, por edhe ndaj çdo njeriu tjetër (nënvizimi ynë). E mira gjithmonë është e mirë, e keqja gjithmonë është e keqe - qëndrimi i drejtë kërkohet vetvetiu, pa marrë parasysh ndaj kujt.

All-llahu xhel-le shanuhu kërkon t’i bëhet mirë fqinjit, edhe nëse s’është musliman.

Kur njeriu përsos moralin e vet ai përsos edhe fenë e vet dhe bëhet musliman shembullarë.

Le të na udhëzojë dhe le të na udhëheqë All-llahu xhel-le shanuhu në rrugë të vërtetë.